



Performanca e sistemit të drejtësisë në trajtimin e krimeve speciale



Autore: Sabina Pergega

Redaktorë: Jeton Hasani dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Shtator, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Performanca e PSRK-së në ndjekjen penale	5
2.1. Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga PSRK.....	6
2.2. Performanca e PSRK-së në zgjidhjen e rasteve sipas kategorive të veprave penale	6
2.3. Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga PSRK-ja për vitin 2021, sipas veprave penale karakteristike	8
3. Performanca e Departamentit Special të GjTh në Prishtinë.....	8
3.1. Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga Departamenti Special gjatë vitit 2021	9
3.2. Ndjekja dhe gjykimi i krimeve të luftës dhe terrorizmit	10
3.3. Ndjekja dhe gjykimi i korrupsionit	11
3.4. Ndjekja dhe gjykimi i krimit të organizuar	11
3.4.1. Dilemat në lidhje me ekzistimin e aktvendimit për fillimin e hetimeve.....	11
4. Departamenti Special i Gjykatës së Apelit.....	12
5. Mungesa e nivelizimit të pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve special.....	13
6. Mungesa e kompensimit të viktimave.....	13
7. Konfiskimi i pasurisë dhe moszbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara	14
8. Paligjshmëria e vendimit të kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë për transferim të lëndëve në Departament Special	14

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2021, IKD ka evidentuar regres në efikasitetin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) në krahasim me vitin paraprak. Kjo pasi që PSRK gjatë vitit 2021 ka zgjidhur më pak lëndë sesa në vitin 2020. Kjo rënie ka rezultuar megjithëse numri i prokurorëve gjatë këtij viti ka qenë i njëjtë dhe nuk ka arsye tjera objektive që arsyetojnë të njëjtën. Kështu, gjatë vitit 2021, prokurorët special (në mesatare) nuk kanë arritur të përmbushin normën orientuese në zgjidhjen e lëndëve.

Në anën tjetër, PSRK, në total, ka pasur sukses relativisht të mirë në aktakuzat që ka ngritur. Kjo pasi që nëse marrim parasysh aktgjykimet dënuese dhe liruese, del se 80.6% e personave të akuzuar nga PSRK janë shpallur fajtorë nga gjykata. Ndërsa, nga totali i personave të dënuar nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë, 53.52% e tyre janë dënuar me burgim efektiv. Megjithatë, këto rezultate nuk hasen edhe në rastet e korrupsionit. Nga të gjitha aktakuzat e ngritura në rastet e korrupsionit për të cilat është shpallur aktgjykim, vetëm 12.5% e tyre kanë qenë të suksesshme në gjykatë.

Sa i përket Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë (DS), IKD ka evidentuar regres edhe në efikasitetin e këtij Departamenti gjatë vitit 2021, në krahasim me vitin 2020. Për dallim nga viti 2021, në të cilin kanë qenë të angazhuar 12 gjyqtarë, në vitin 2020 kanë qenë të angazhuar vetëm gjashtë gjyqtarë në këtë Departament. Po ashtu, gjatë vitit 2020, për disa muaj rresht për shkak të pandemisë COVID-19, ishte reduktuar dukshëm puna e gjyqësorit. Megjithatë, këta gjashtë gjyqtarë të DS në vitin 2020 kanë zgjidhur më shumë lëndë sesa dymbëdhjetë gjyqtarë në vitin 2021. Ky regres gjatë vitit 2021 pothuajse ka dyfishuar numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese (nga 59 në 101).


Ndërsa Departamenti Special i Gjykatës së Apelit ka një stabilitet të caktuar në punën e tij, pasi si në fund të vitit 2020 ashtu edhe në fund të vitit 2021, i kanë mbetur të pazgjidhura vetëm nga 5 lëndë. Megjithatë, në vitin 2020 kanë qenë të angazhuar tre gjyqtarë në këtë Departament, ndërkaq në vitin 2021 ky numër është ngritur në gjashtë. Por, rezultati prapë ka qenë i njëjtë. Në fakt, përderisa ky Departament në fund të vitit 2020 ka pasur një numër të kufizuar të rasteve, është supozuar fakti se prapë numri i lëndëve të mbetura në punë, për arsye objektive, nuk do të bie në zero. Kështu, ishte i paarsyeshëm avancimi i tre gjyqtarëve shtesë në këtë Departament. Duke vepruar në këtë mënyrë, KGJK pa nevojë ka rritur numrin e gjyqtarëve në këtë Departament, duke dobësuar kështu departamentet dhe gjykatat prej nga vijnë gjyqtarët e avancuar.

Gjatë analizimit të aktgjytimeve të nxjerra nga Departamenti Special i GjTh në Prishtinë, IKD ka gjetur se në dhjetë prej tyre kishte palë të dëmtuara nga veprat penale. Nga këto dhjetë raste, në vetëm dy prej tyre Departamenti Special e ka obliguar të akuzuarin që palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar nga kryerja e veprës penale, ndërsa në tetë rastet tjera pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil. Kështu, në këto raste, palët e dëmtuara janë udhëzuar që realizimin e kërkesës së tyre pasurore juridike ta bëjnë në kontest civil, në vend se gjykata të vendosë vetë në procedurë penale. Një gjë e tillë ndodhë për shkak të lëshimeve të akterëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë.

Në anën tjetër, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë mundëson aplikimin e procedurës së verifikimit dhe konfiskimit civil të pasurisë së të pandehurit në rastet kur i pandehuri shpallet fajtor në një procedurë penale. Përkundër kësaj mundësie të dobishme ligjore për luftim të kriminalitetit, IKD ka gjetur se gjatë vitit 2021 në asnjë rast nuk është aplikuar kjo procedurë nga ana e Prokurorit të Shtetit. Për aplikimin e këtij Ligji nga ana e Prokurorit të Shtetit, pra, mjafton vetëm shpallja fajtor e të pandehurit nga gjykata. Andaj, mungesa e zbatimit të këtij Ligji ndaj personave të shpallur fajtorë flet për një shpërfillje të lartë të kompetencave nga Prokurori i Shtetit në këtë fushë.

2. Performanca e PSRK-së në ndjekjen penale

Sipas raportit vjetor të Prokurorit të Shtetit për vitin 2021, rezulton se gjatë këtij viti PSRK ka pasur në punë 1989 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur 272 lëndë apo 14%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 1717 lëndë apo 86%. Në anën tjetër, në vitin 2020 prokurorët special kanë pasur në punë më shumë lëndë se në vitin 2021 (gjithsej 2176 lëndë), ku kanë zgjidhur më shumë prej tyre sesa në 2021 (576 lëndë apo 26%). Kështu, përkundër faktit se gjatë vitit 2021 nuk janë paraqitur ndryshime rrënjësore në punën e PSRK-së dhe numri i prokurorëve ka qenë i njëjtë, prokurorët e PSRK-së kanë zgjidhur përgjysmë më pak lëndë gjatë vitit 2021 në krahasim me vitin 2020. Kjo përbën një regres në efikasitetin e PSRK.



Grafika 1: Përqindja e zgjidhjes së lëndëve nga PSRK-ja gjatë periudhës 2020-2021

Gjatë vitit 2020, 16 prokurorët special kanë zgjidhur gjithsej 576 lëndë, që i bie se në mesatare prokurorët e PSRK kanë zgjidhur nga 36 lëndë në vit, përkatësisht 14 lëndë më shumë sesa norma vjetore e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.01/2018 për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit.¹ Ndërsa, gjatë vitit 2021, 16 prokurorët special kanë zgjidhur vetëm 272 lëndë, që i bie se, si tërësi, prokurorët e PSRK kanë zgjidhur vetëm nga 17 lëndë në vit. Kjo shifër nënkupton se prokurorët special, si tërësi, kanë zgjidhur gjatë vitit 2021 lëndë më pak sesa norma e përcaktuar orientuese sipas së cilës një prokuror duhet të zgjidhë 22 raste në vit.

Sipas komenteve që PSRK ka dhënë për këtë Raport, numri i lëndëve të zgjidhura me kryes të njohur të veprave penale (PP/S), si lëndët kryesore të cilat trajton PSRK, nuk ka pësuar rënie të theksuar, derisa diferencën e madhe me vitin 2020 e ka bërë numri i lëndëve të ndihmës

¹ Neni 2, paragrafi 1, pika 1.6: “Prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës janë të obliguar që të kryejnë së paku 2 kallëzime penale - lëndë penale në muaj, përkatësisht 22 kallëzime - lëndë penale në vit.”

juridike ndërkombëtare. Në vitin 2021 janë zgjidhur gjithsej 64 lëndë të kësaj natyre, ndërsa në vitin 2020 janë zgjidhur 296.

Fillimisht, duhet theksuar faktin se edhe sa i përket numrit të lëndëve me kryes të njohur, PSRK gjatë vitit 2021 ka zgjidhur më pak lëndë sesa në vitin 2020. Kjo pasi përderisa në vitin 2020 PSRK ka zgjidhur gjithsej 104 lëndë të kësaj natyre, në vitin 2021 ky numër ka qenë 100. Po ashtu, edhe diferenca në mes të numrit të lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura në vitin 2021 ka qenë më negative në raport me vitin 2020. Sa i përket lëndëve PP/S, përderisa në vitin 2020 PSRK ka zgjidhur 10 lëndë më pak se sa që ka pranuar, në vitin 2021 janë zgjidhur 28 lëndë më pak sesa që janë pranuar. Kjo ka bërë që PSRK të fillojë vitin 2021 me 509 lëndë të pazgjidhura dhe ta mbyll me 537 lëndë të pazgjidhura.

Në anën tjetër, nëse e shohim si total, gjatë vitit 2021 PSRK ka zgjidhur gjithsej 304 lëndë më pak sesa në vitin 2020. Ndërsa, gjatë vitit 2020, PSRK ka gjithsej 232 lëndë më shumë të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar sesa në vitin 2020. Kështu, nuk qëndron argumenti se diferençën e kanë bërë vetëm këto lëndë, pasi diferenca e numrit të përgjithshëm të rasteve është më e lartë se diferenca e rasteve të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Andaj, edhe sipas këtyre të dhënave, del se gjatë vitit 2021 PSRK ka shënuar regres në efikasitet.

2.1. Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga PSRK

PSRK gjatë vitit 2021 ka zgjidhur rastet e 434 personave, ku për 125 persona ka ngritur aktakuza, për 142 persona ka pushuar hetimet, për 133 persona ka hedhur kallëzimet penale dhe rastet e 34 personave i ka ceduar në kompetencë.

	Aktakuza	Pushim i hetimeve	Hedhje e kallëzimeve penale	Ceduar në kompetencë
2020	143	97	116	55
2021	125	142	133	34

Tabela 1: Mënyra e zgjedhjes së rasteve nga PSRK për persona gjatë periudhës 2020-2021

Ndërsa, gjatë vitit 2020, edhe pse PSRK ka trajtuar numër më të vogël të personave të dyshuar, ka ngritur më shumë aktakuza se në vitin 2021, duke ngritur aktakuzë ndaj 143 personave. Njëherit, gjatë vitit 2021 rezulton se ka pasur më shumë raste kur kanë pushuar hetimet krahasuar me vitin 2020 (për 142 persona, kundrejt 97 sa ishin në 2020).

2.2. Performanca e PSRK-së në zgjidhjen e rasteve sipas kategorive të veprave penale

Nga kategoria e veprave penale² të krimit të organizuar, PSRK-ja gjatë vitit 2021, nga gjithsej 54 raste në punë (ku përfshihen 353 persona), i ka zgjidhur vetëm 7 raste (me 54 persona), ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura edhe 47 raste të tjera me 299 persona.

² Sqarim: Sipas PSRK-së, rastet regjistrohen sipas veprës penale si janë parashtruar fillimisht dhe nëse hetimet zhvillohen edhe për vepra të tjera penale, sistemi e pamundëson një regjistrim të dytë. Në këtë Raport paraqiten të dhënat ashtu siç janë pasqyruar në raportet vjetore të Prokurorit të Shtetit.

Për vepra penale të terrorizmit, PSRK gjatë vitit 2021 ka zgjidhur 9 raste (ku përfshihen 25 persona), ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 55 raste (ku përfshihen 139 persona).

Ndërsa për vepra penale të krimeve të luftës, PSRK-ja krahasuar me numrin e madh të lëndëve që ka pasur në punë (gjithsej 336 raste ku përfshihen 1376 persona), gjatë vitit 2021 i ka zgjidhur vetëm 5 raste me 15 persona.

	Raste të reja		Gjithsej raste		Të zgjidhura		Të pazgjidhura	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
Krim i organizuar	19	148	54	353	7	54	47	299
Terrorizëm	7	22	64	164	9	25	55	139
Krime të luftës	12	284	336	1376	5	15	331	1361

Tabela 2: Mënyra e zgjidhjes së rasteve të krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimeve të luftës nga PSRK-ja për vitin 2021

Nëse krahasojmë departamentet brenda PSRK-së në korrelacion me numrin e prokurorëve të angazhuar në secilin Departament, atëherë i bie se efikasitetin më të ulët e ka pasur Departamenti për Krime Luftë. Sipas të dhënave të publikuara në faqen e PSRK-së, në këtë Departament janë të angazhuar gjithsej katër prokurorë.³ Kështu, i bie se mesatarisht secili prokuror brenda një viti nuk ka kryer as nga dy lëndë. Në anën tjetër, në Departamentin për Terrorizëm, përkundër se janë të angazhuar dy prokurorë, janë zgjidhur gjithsej nëntë raste ku përfshihen 139 persona. Kështu, dallimet janë shumë të mëdha. Për këtë arsye, krahas kërkesës së vazhdueshme për ngritje të numrit të prokurorëve të cilët trajtojnë rastet e krimeve të luftës, për mungesë të efikasitetit në përgjegjësi profesionale duhet të merren edhe prokurorët që aktualisht janë duke trajtuar lëndë të kësaj natyre. Përkundër sfidave në trajtimin e këtyre rasteve, duhet të kujtojmë faktin se raporti i IKD për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës gjente se ka familjar të viktimave të luftës të cilët asnjëherë nuk janë intervistuar nga PSRK.⁴

³ Sqarim: Në raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit dhe në faqen zyrtare të Prokurorit të Shtetit nuk ka informacione nëse këta prokurorë janë angazhuar edhe në raste të natyrave të tjera; <https://prokuroria-rks.org/psh/prokuroria-speciale/401/departamenti-pr-krime-lufte>.


⁴ Sabina Pergega, Mirvet Thaqi dhe Medina Kadriu, “Amnistia e Krimeve të Luftës në Kosovë” (Instituti i Kosovës për Drejtësi, 2020): <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/09/IKD-Amnistia-e-Krimeve-te-Luftes-ne-Kosove-17.09.2020-1.pdf>.

2.3. Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga PSRK-ja për vitin 2021, sipas veprave penale karakteristike

Për veprat penale⁵ krim i organizuar, PSRK gjatë vitit 2021 ka zgjidhur rastet e 54 personave, ku në 29 prej tyre ka ngritur aktakuza, ndaj 8 personave ka hedhur kallëzimet penale dhe ndaj 17 personave ka pushuar hetimet.

Për veprat penale të terrorizmit, PSRK gjatë vitit 2021 ka zgjidhur rastet e 25 personave, ku ndaj 10 prej tyre ka ngritur aktakuza dhe ndaj 15 personave ka pushuar hetimet.

Ndërsa për rastet e krimeve të luftës, gjatë vitit 2021, PSRK ka zgjidhur rastet e 16 personave, ku për dy persona ka ngritur aktakuza, për 11 persona ka hedhur kallëzimet penale dhe për tre persona ka pushuar hetimet.⁶



Grafika 2: Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga PSRK-ja për persona, sipas veprave penale karakteristike

3. Performanca e Departamentit Special të GjTh në Prishtinë


Themelimi i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pasur për qëllim, ndër të tjera, rritjen e efikasitetit të gjyqësorit në trajtimin e rasteve të iniciuara nga PSRK. Gjetjet e IKD dëshmojnë se ky Departament nuk ka arritur të përmbush mjaftueshëm këtë qëllim të themelimit, pasi rezulton se nuk ka treguar efikasitet të duhur në zgjidhjen e lëndëve.

Gjatë vitit 2021, ky Departament ka pranuar në punë 72 raste, ndërkaq i ka trashëguar nga viti 2020 edhe 66 raste. Pra, gjatë vitit 2021 DS ka pasur në punë gjithsej 138 raste, prej të cilave ka arritur që t'i zgjidhë vetëm 37 raste (27% të lëndëve), ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 101 raste.

⁵ Sqarim: Sipas PSRK-së, rastet regjistrohen sipas veprës penale si janë parashtruar fillimisht dhe nëse hetimet zhvillohen edhe për vepra të tjera penale, sistemi e pamundëson një regjistrim të dytë. Në këtë Raport paraqiten të dhënat ashtu siç janë pasqyruar në raportet vjetore të Prokurorit të Shtetit.

⁶ Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit 2021, shkurt 2022.

Nëse e krahasojmë me vitin 2020, atë vit Departamenti Special ka pasur më pak lëndë në punë (110 lëndë), por ka zgjidhur 51 lëndë (46% të lëndëve).




Grafika 3: Ngarkesa e DS-së me lëndë dhe efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve gjatë viteve 2020-2021

Për dallim nga viti 2021, në të cilin kanë qenë të angazhuar 12 gjyqtarë, në vitin 2020 kanë qenë të angazhuar vetëm gjashtë gjyqtarë. Po ashtu, gjatë vitit 2020, për disa muaj, për shkak të pandemisë COVID-19, ishte reduktuar dukshëm puna e gjyqësorit. Megjithatë, këta gjashtë gjyqtarë në vitin 2020 kanë zgjidhur më shumë raste sesa 12 gjyqtarë në vitin 2021. Kështu, IKD gjen se gjatë vitit 2021 ka regres të theksuar në efikasitetin e Departamentit Special. Ky regres pothuajse ka dyfishuar (nga 59 në 101) numrin e lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

3.1 Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga Departamenti Special gjatë vitit 2021

IKD ka analizuar 32 raste të DS të cilat kanë përfunduar me aktgjykim gjatë vitit 2021, ku përfshihen 91 persona. Nga këto raste, 22 kanë përfunduar me aktgjykim dënues (14 me burgim efektiv, 4 raste me dënime me gjobë, dhe 4 raste dënime me kusht), 8 raste kanë përfunduar me aktgjykim lirues, në një rast është arritur parashkrimi absolut dhe në një rast gjykata ndaj një të akuzuari ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Në grafikën në vijim pasqyrohet mënyra e zgjidhjes së rasteve për persona nga DS:



Grafika 4: Mënyra e zgjidhjes së rasteve nga DS për persona për vitin 2021

Sipas këtyre të dhënave, del se PSRK në përgjithësi ka pasur sukses relativisht të mirë në aktakuzat që ka ngritur. Kjo pasi nëse marrim parasysh aktgjykimet dënuese dhe liruese, i bie se 80.6% e personave të akuzuar nga PSKR-ja janë shpallur fajtorë nga gjykata. Ndërsa, nga totali i personave të dënuar nga Departamenti Special, 53.52% e tyre janë dënuar me burgim efektiv.

3.2 Ndjekja dhe gjykimi i krimeve të luftës dhe terrorizmit

Dënimet më të ashpra në DS janë shpallur për vepra penale të krimeve të luftës, ku gjatë vitit 2021 katër raste kanë përfunduar me aktgjykime dënuese, derisa dy raste janë ende në proces. Mesatarja e dënimeve të shqiptuara me burgim efektiv gjatë vitit 2021 për vepra penale të krimeve të luftës është 12 vite e gjysmë.

Gjatë këtij viti, dënimi më i ashpër për krime lufte është ai ndaj Goran Stanishiqit, i cili është dënuar me 20 vite burgim,⁷ pastaj me 14 vite burgim është dënuar Zoran Krstiq i akuzuar së bashku me Destan Shabanin (i dënuar me 7 vite),⁸ pastaj me 12 vite është dënuar Zoran Gjokiq⁹ dhe me 10 vite është dënuar i akuzuari për dhunë seksuale gjatë luftës, Zoran Vukotiq.¹⁰

Departamenti Special i GjTh në Prishtinë, gjatë vitit 2021 ka përfunduar me aktgjykim 5 raste të terrorizmit, ku përfshihen 6 persona (2 persona janë dënuar me burgim efektiv dhe 4 prej

⁷ "Goran Stanishiq dënohet me 20 vite burgim për vrasjen e 13 civilëve gjatë luftës në Kosovë," Betimi për Drejtësi, 5 tetor 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/goran-stanishiq-denohet-me-20-vite-burgim-per-vrasjen-e-13-civileve-gjate-luftes-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 12 gusht 2022).

⁸ "Apeli vërteton aktgjykimin dënues të shkallës së parë ndaj dy të akuzuarve për krime lufte në Nerodime të Epërme," Betimi për Drejtësi, 2 dhjetor 2021. (Shih linkun: [Apeli vërteton aktgjykimin dënues të shkallës së parë ndaj dy të akuzuarve për krime lufte në Nerodime të Epërme - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-denues-te-shkallës-së-parë-ndaj-dy-të-akuzuarve-për-krime-lufte-në-nerodime-të-epërme/)). (Qasur për herë të fundit më 26 gusht 2022).

⁹ "Supremja konfirmon dënimin me 12 vite burgim ndaj Zoran Gjokiq, për krime lufte në Pejë," Betimi për Drejtësi, 30 mars 2022. (Shih linkun: [Supremja konfirmon dënimin me 12 vite burgim ndaj Zoran Gjokiq, për krime lufte në Pejë - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konfirmon-dënimin-me-12-vite-burgim-ndaj-zoran-gjokiq-për-krime-lufte-në-pejë-betimi-për-drejtesi/)). (Qasur për herë të fundit më 20 gusht 2022).

¹⁰ "Zoran Vukotiq dënohet me 10 vite burgim pasi akuzohej se gjatë luftës dhunoi një shqiptare në Vushtrri," Betimi për Drejtësi, 5 korrik 2021. (Shih linkun: [Zoran Vukotiq dënohet me 10 vite burgim pasi akuzohej se gjatë luftës dhunoi një shqiptare në Vushtrri - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/zoran-vukotiq-denohet-me-10-vite-burgim-pasi-akuzohej-se-gjatë-luftës-dhunoi-një-shqiptare-në-vushtrri-betimi-për-drejtesi/)). (Qasur për herë të fundit më 1 shtator 2022).

tyre janë liruar nga akuza). Dënimi më i ashpër i shqiptuar gjatë vitit 2021 për terrorizëm është me tri vite burgim.

3.3. Ndjekja dhe gjykimi i korrupsionit

Gjatë vitit 2021, DS i GjTh në Prishtinë ka qenë i ngarkuar me 17 raste të korrupsionit, prej të cilave i ka zgjidhur 7 raste (ku përfshihen 16 persona). Nga këta 16 persona, 12 persona janë liruar nga akuza, 2 janë dënuar me gjobë dhe ndaj 2 personave është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Kështu, përballë suksesit të aktakuzave të PSRK-së si total, rezultat të kundërt kemi në rastet e korrupsionit: nga të gjitha aktakuzat e ngritura për të cilat është shpallur aktgjykimi, vetëm 12.5% e tyre kanë qenë të suksesshme në gjykatë.

Në dy rastet e korrupsionit kur janë shqiptuar aktgjykime dënuese, në asnjërin rast nuk është shqiptuar dënim me burgim efektiv. Njëherit, megjithëse Departamenti Special gjatë kësaj periudhe ka pasur në punë edhe lëndë të korrupsionit të profilit të lartë, asnjë prej rasteve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe nuk është e tillë.

3.4. Ndjekja dhe gjykimi i krimit të organizuar

Departamenti Special i GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2021 ka pasur në punë 15 raste të krimit të organizuar, prej të cilave i ka zgjidhur vetëm 3 (apo 20%). Për këto tri raste PSRK-ja fillimisht kishte ngritur aktakuzë për krim të organizuar, por gjatë shqyrtimit gjyqësor në dy raste ka hequr dorë nga ndjekja penale për krim të organizuar, ndërsa ka vazhduar procedurën për vepra tjera penale.¹¹ Ndërkaq, në rastin e gjykuar për krim të organizuar dhe shmangie nga tatimi ndaj nëntë të akuzuarve, DS ka shqiptuar dënim mbi 47 vite burgim në total dhe 25,500 euro gjobë.¹²

3.4.1. Dilemat në lidhje me ekzistimin e aktvendimit për fillimin e hetimeve

Më 27 shtator 2019, PSRK kishte ngritur aktakuzë ndaj një grupi personash të dyshuar për krim të organizuar lidhur me narkotikë. Sipas PSRK-së, të akuzuarit kishin transportuar gjithsej 250 kilogram marihuanë nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut, ku Kosova ishte vend transit.

Kjo aktakuzë ishte përpiluar nga prokurori Blerim Isufaj, i cili gjithashtu mban pozitën e Kryeprokurorit të PSRK. Fillimisht, ky rast ndaj nëntë të akuzuarve kishte përfunduar me

¹¹ “Dënohen me 66 muaj burgim dhe 47 mijë euro gjobë shtatë të akuzuarit për kontrabandim të migrantëve nga Kosova për në vendet e BE-së”, Betimi për Drejtësi, 25 janar 2021. (Shih linkun: [Dënohen me 66 muaj burgim dhe 47 mijë euro gjobë shtatë të akuzuarit për kontrabandim të migrantëve nga Kosova për në vendet e BE-së - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](#)). (Qasur për herë të fundit më 1 shtator 2022). “Afër 25 vite burgim dhe 12 mijë euro gjobë ndaj të akuzuarve për transportim të drogës nga Maqedonia e Veriut në Kosovë dhe anasjelltas”, Betimi për Drejtësi, 30 nëntor 2021. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/afer-25-vite-burgim-dhe-12-mije-euro-gjobe-ndaj-te-akuzuarve-per-transportim-te-droges-nga-maqedonia-e-veriut-ne-kosove-dhe-anasjelltas/>). (Qasur për herë të fundit më 1 shtator 2022).

¹² “Mbi 47 vite burgim dhe 25,500 euro gjobë ndaj nëntë të akuzuarve për krim të organizuar me narkotikë”, Betimi për Drejtësi, 26 shkurt 2021. (Shih linkun: [Mbi 47 vite burgim dhe 25,500 euro gjobë ndaj nëntë të akuzuarve për krim të organizuar me narkotikë - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](#)). (Qasur për herë të fundit më 1 shtator 2022).

aktgjykim dënues,¹³ por pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer rastin në rigjykim vetëm për një të pandehur (Adam Nezajn), DS e kishte refuzuar aktakuzën ndaj tij duke vlerësuar që prokurori i rastit kishte bërë lëshime procedurale, duke pamundësuar kështu gjykimin meritor të tij.¹⁴

Kështu, sipas Gjykatës, prokurori i rastit, Blerim Isufaj, nuk kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve dhe zgjerimin e hetimeve ndaj Nezajt. Përballë këtij fakti, aktakuza ndaj këtij të pandehuri u refuzua nga Gjykata, megjithëse para se rasti të rikthehej nga Apeli i njëjti ishte shpallur fajtor për transportim të mbi 200 kg të narkotikëve në kuadër të grupit të organizuar kriminal.

Pas këtij aktgjykimi, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte ndjekur rrugët ligjore, duke e atakuar këtë vendim në instancat më të larta gjyqësore. Prokuroria e Apelit e aprovoi ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, duke e kthyer rastin në rivendosje dhe duke konstatuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje sa i përket aktvendimit për fillimin e hetimeve. Pas kësaj, Adam Nezaj u shpall fajtor dhe u dënua nga Gjykata. Gjykata e Apelit Konfirmoj dënimin prej 5 vite burgim dhe 2.500 euro gjobë të shqiptuar ndaj Nezajt.¹⁵

4. Departamenti Special i Gjykatës së Apelit

Ky Departament gjatë vitit 2021 ka pasur të angazhuar gjashtë gjyqtarë, të cilët kanë pasur në punë 41 lëndë, nga të cilat i kanë zgjidhur 36, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 5 lëndë.

Ndërsa gjatë vitit 2020, në këtë Departament kanë qenë të angazhuar vetëm tre gjyqtarë, të ngarkuar me 53 lëndë, por i kanë zgjidhur 48 ndërsa u kanë mbetur të pazgjidhura vetëm 5 lëndë.

Kështu, si në rastin kur DS i GjA ka pasur në punë 41 lëndë dhe kanë qenë të angazhuar gjashtë gjyqtar, ashtu edhe kur ka pasur në punë 53 lëndë dhe kanë qenë të angazhuar tre gjyqtarë, të pazgjidhura në fund të vitit kanë mbetur vetëm 5 lëndë. Ky numër i lëndëve të pazgjidhura është i menaxhueshëm dhe paraqet efikasitet të këtij Departamenti.

¹³ “Mbi 47 vite burgim dhe 25,500 euro gjobë ndaj nëntë të akuzuarve për krim të organizuar me narkotikë”, Betimi për Drejtësi, 26 shkurt 2021. (Shih linkun: [Mbi 47 vite burgim dhe 25.500 euro gjobë ndaj nëntë të akuzuarve për krim të organizuar me narkotikë - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](#)). (Qasur për herë të fundit më 1 shtator 2022).

¹⁴ “Shtetasit të Shqipërisë i refuzohet akuza për trafikim të narkotikut në Kosovë, me destinacion Maqedoninë e Veriut”, Betimi për Drejtësi, 14 janar 2022. (Shih linkun: [Shtetasit të Shqipërisë i refuzohet akuza për trafikim të narkotikut në Kosovë, me destinacion Maqedoninë e Veriut - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](#)). (Qasur për herë të fundit më 1 shtator 2022).

¹⁵ “Apeli vërteton dënimin me 5 vite burgim dhe 2 mijë e 500 euro gjobë ndaj shtetasit të Shqipërisë, për transportimin e mbi 500 kilogramëve marihuanë”, Betimi për Drejtësi, 10 dhjetor 2023. (Shih linkun [Apeli vërteton dënimin me 5 vite burgim dhe 2 mijë e 500 euro gjobë ndaj shtetasit të Shqipërisë, për transportimin e mbi 500 kilogramëve marihuanë - Betimi për Drejtësi](#)). (Qasur për herë të fundit më 5 nëntor 2024). Shënim: Ky kapitull është plotësuar pas publikimit të raportit, me zhvillimet e reja që kanë ndodhur në këtë rast, pas nxjerrjes së aktgjykimeve në instanca më të larta gjyqësore pas ushtrimit të mjeteve juridike nga PSRK.

Por, siç shihet, në të dy vitet nuk ka pasur numër të njëjtë të gjyqtarëve. Përderisa në vitin 2020 kanë qenë të angazhuar tre gjyqtarë në këtë Departament, në vitin 2021 ky numër është ngritur në gjashtë. Por, rezultati prapë ka qenë i njëjtë. Në fakt, përderisa ky Departament në fund të vitit 2020 ka pasur një numër të kufizuar të rasteve, është supozuar fakti se prapë numri i lëndëve të mbetura në punë, për arsye objektive, nuk do të bie në zero. Kështu, ishte i

paarsyeshëm avancimi i tre gjyqtarëve shtesë në këtë Departament. Duke vepruar në këtë mënyrë, KGJK ka rritur pa nevojë numrin e gjyqtarëve në këtë Departament, duke dobësuar kështu departamentet dhe gjykatat prej nga vijnë gjyqtarët e avancuar.

5. Mungesa e nivelizimit të pagave të prokurorëve dhe gjyqtarëve special

Nga të dhënat e deklarimit të pasurisë në AKK, një prokuror special në muaj paguhet përafërsisht mbi 2,800 euro, ndërsa paga e një gjyqtari të Departamentit Special është përafërsisht 2,000-2100 euro në muaj, apo mbi 700 euro më pak se një prokuror.

Lidhur me këtë diferencim të pagave, Komisioni për Buxhet i Këshillit Gjyqësor të Kosovës tri herë ka kërkuar nga Ministria e Financave që paga e gjyqtarëve special të jetë ekuivalente me atë të prokurorëve special, por kjo kërkesë nuk është përkrahur.

Duhet theksuar faktin se legjislacioni në fuqi përcakton, varësisht nivelit, paga të barabarta për gjyqtarët dhe prokurorët. Kjo pasi që prokurorët dhe gjyqtarët trajtojnë rastet e njëjta, por nga dimensionet e ndryshme. Në këtë rast, IKD gjen se përjashtim nga gjitha departamentet e tjera bën vetëm Departamenti Special. Përderisa prokurorët special dhe gjyqtarët special trajtojnë rastet e natyrave të njëjta, atëherë edhe pagesa për ta duhet të jetë e njëjtë dhe të shmangen diferencimet.

6. Mungesa e kompensimit të viktimave

Gjatë analizimit të aktgjykimeve të nxjerra nga Departamenti Special i GjTh në Prishtinë, IKD ka gjetur se në dhjetë prej tyre kishte palë të dëmtuara nga veprat penale. Nga këto dhjetë raste, në vetëm dy prej tyre Departamenti Special ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar nga kryerja e veprës penale, ndërsa në tetë rastet tjera pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil.

Kur në procedurë penale gjykata nuk vendos lidhur me kërkesën pasurore juridike, atëherë palës së dëmtuar i duhet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë përmes procedurës civile. Në këtë mënyrë, pala e dëmtuar duhet të ndjekë edhe një proces tjetër gjyqësor për të realizuar të drejtat e veta. Një gjë e tillë mund të ndikojë edhe në hezitimin e palëve të dëmtuara për të kërkuar realizimin e kërkesës që u takon me ligj, duke mos dëshiruar të përballën edhe me një procedurë tjetër (të gjatë) gjyqësore. Krahas interesit të palës, kjo mënyrë e veprimit e ngarkon edhe sistemin e drejtësisë, për shkak se për çështjen e njëjtë gjykatat duhet të vendosin në dy procese gjyqësore (penale dhe civile).

Në anën tjetër, KGJK duhet ta ketë parasysh faktin se në këto raste pala e dëmtuar është duke kaluar në dy procese gjyqësore për rastin e njëjtë. Prandaj, IKD i rekomandon KGJK që në këto

raste ta shqyrtojë mundësinë që paditë në procedurë civile për rastet kur është zhvilluar edhe procedura penale të mos trajtohen si lëndë të reja (sipas datës së ngritjes së padisë) por të trajtohen sipas datës së ngritjes së aktakuzës. Efektet pozitive, veçanërisht, do të rezultojnë tek mos hezitimi i palëve të dëmtuara për të paraqitur kërkesën pasurore juridike në procedurë civile.

Por, përtej përgjegjësisë së gjykatave që në procedurë penale të vendosin në mënyrë meritore edhe për kërkesën pasurore juridike, duhet thënë që në shumicën e rasteve vet palët e dëmtuara (përkatësisht mbrojtësit e tyre) nuk e përcaktojnë dëmin që pretendohet se u është shkaktuar nga vepra penale. Duke mos e bërë këtë, gjykatës i pamundësohet të vendos mbi kërkesën pasurore juridike dhe detyrimisht palën e dëmtuar e udhëzon në kontest civil.

7. Konfiskimi i pasurisë dhe moszbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara

Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë mundëson aplikimin e procedurës së konfiskimit civil në rastet kur i pandehuri shpallet fajtor.¹⁶ Përkundër kësaj mundësie ligjore, IKD ka gjetur se gjatë vitit 2021 në asnjë rast nuk është aplikuar kjo procedurë nga ana e Prokurorit të Shtetit. Mos aplikimin e këtij ligji raportet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik e cilësojnë si të metë, por se nuk japin arsye të mjaftueshme se pse nuk zbatohet ky ligj, derisa raportet paraprake rekomandonin veprimin e mekanizmave të llogaridhënies në këtë fushë.

Për aplikimin e këtij ligji nga ana e Prokurorit të Shtetit mjafton vetëm shpallja fajtor e të pandehurit, prandaj mos aplikimi i tij flet për një shpërfillje të paarsyeshme të kompetencave të Prokurorit të Shtetit në këtë fushë.

8. Paligjshmëria e vendimit të kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë për transferim të lëndëve në Departament Special

Vendimi i kryetares së GjTh në Prishtinë Albina Shabani-Rama për transferim të 30 lëndëve nga Departamenti për Krime të Rënda në Departamentin Special të GjTh në Prishtinë, ndonëse ishte ndërmarrë me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe trajtimit të tyre brenda një afati të arsyeshëm,¹⁷ ishte nxjerrë në kundërshtim me nenin 42, par. 4 të Ligjit për Gjykatat. Kjo dispozitë kalimtare parasheh mundësinë e transferimit të lëndëve të ushtruara sipas aktakuzave të PSRK-së në DS vetëm për lëndët për të cilat nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, ndërsa lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre. Duke qenë se për lëndët e transferuara shqyrtimi gjyqësor është dashur të fillojë rishtas, një gjë e tillë ka ndikuar në zvarritje procedurale të këtyre rasteve dhe ka kontribuar në të dhënat e mësipërme që shpërfaqin regresin në efikasitet të

¹⁶ Ligji nr.06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë, neni 2.

¹⁷ Vendimi nr. GjA.577/21 (7 tetor 2021).

Departamentit Special. Disa nga këto lëndë të transferuara janë “Rasti i Aktivistëve të VV-së”,¹⁸ rastet “Toka” dhe “Toka 2”,¹⁹ rasti i Leunis Frangut,²⁰ etj.

¹⁸ “Pas ndërrimit të gjyqtarit, në dhjetor pritet të nis gjykimi ndaj ish-deputetit Frashër Krasniqi dhe të tjerëve”, Betimi për Drejtësi, 9 nëntor 2021. (Shih linkun: [Pas ndërrimit të gjyqtarit, në dhjetor pritet të nis gjykimi ndaj ish-deputetit Frashër Krasniqi dhe të tjerëve - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/pas-nderrimit-te-gjyqtarit-ne-dhjetor-pritet-te-nis-gjykimi-ndaj-ish-deputetit-frasher-krasniqi-dhe-te-tjereve)). (Qasur për herë të fundit më 20 gusht 2022).

¹⁹ “Rasti ‘Toka’, shembull i dështimit të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”, Betimi për Drejtësi, 18 prill 2022. (Shih linkun: [Rasti “Toka”, shembull i dështimit të sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-shembull-i-deshtimit-te-sistemit-te-drejtesisë-ne-luftën-kundër-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar)). (Qasur për herë të fundit më 15 gusht 2022).

²⁰ “Herën e katërt shpallet fajtor i akuzuari për pjesëmarrje në luftërat e Sirisë, dënohet me tri vite burgim”, Betimi për Drejtësi, 13 maj 2022. (Shih linkun: [Herën e katërt shpallet fajtor i akuzuari për pjesëmarrje në luftërat e Sirisë, dënohet me tri vite burgim - Betimi për Drejtësi \(betimiperdrejtesi.com\)](https://betimiperdrejtesi.com/heren-e-katërt-shpallet-fajtor-i-akuzuari-për-pjesëmarrje-në-luftërat-e-sirisë-dënohet-me-tri-vite-burgim)). (Qasur për herë të fundit më 12 gusht 2022).